

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 21.09.2018]

Për: Operatorin Ekonomik “Alb Star” shpk, me adrese: Zona Industriale, Patos, Fier, me NIPT J62903512W.

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **"Rikonstruksion /rikualifikimi urban prane Qendres se qytetit Vlore”Zona B drejtim rruges Justin Godart".**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rikonstruksion /rikualifikimi urban prane Qendres se qytetit Vlore” Zona B drejtim rruges Justin Godart".**

Numri i referencës së procedurës: **REF-76089-06-23-2018.**

Kohëzgjatja: brënda 6 muaj nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 157.222.127 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milion e dyqind e njëzet e dy mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë pa tvsh. Fondi i akorduar për vitin 2018 është 37.239.438 lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2019.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 27.08.2018.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	NIPTI	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	"BE IS" SHPK (75.2%)	K71412003A	136,570,738
	"MANE S" SHPK (24.8%)	J64103865K	

2	"LEON KONSTRUKSION" SHPK (86%)	K71820009I	138,025,040
	"ITE GROUP" SHPK (14%)	K11323001H	
3	"R&T" SHPK	J61901094G	142,814,428
4	"ALBSTAR" SHPK	J62903512W	149,688,322
5	"VELLEZERIT HYSA" SHPK	K12911201C	NUK KA PARAQITUR OFERTE

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Be Is" shpk (75.2%) dhe "Mane/S" shpk (28.4%) pasi:

Shoqeria "Be Is" shpk nuk ploteson kerkesen per disponimin e licenses per shoqerine per zbatim ne restaurimin dhe rikualifikimin e qendrave historike, ne perputhje me kerkesen e paraqitur ne kerkesat e vecanta te kualifikimit ku citohet se shoqeria duhet te disponoje licensen: *"A/Z – 4 Zbatim ne restaurimin dhe rikualifikimin e qendrave historike. Ne rastin e bashkimit te shoqerive, secila shoqeri pjesemarrese ne bashkim duhet te disponoje licensen A/Z – 4"*.

Shoqeria "Be Is" shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me stafin drejtues te shoqerise, pasi arkitekti i deklaruar me license nga Ministria e Kultures per zbatim ne restaurimin e monumenteve te trashegimise se arkitektures disponon pikat A/3 dhe A/4 por nuks disponon piken AZ/1 te kerkuar ne kerkesen per kualifikim.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

2. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Leon Konstruksion" shpk (86%) dhe "ITE Group" shpk (14%) pasi:

Shoqeria "ITE Group" shpk nuk ploteson kerkesen per disponimin e licenses per shoqerine per zbatim ne restaurimin dhe rikualifikimin e qendrave historike, ne perputhje me kerkesen e paraqitur ne kerkesat e vecanta te kualifikimit ku citohet se shoqeria duhet te disponoje licensen: *"A/Z – 4 Zbatim ne restaurimin dhe rikualifikimin e qendrave historike. Ne rastin e bashkimit te shoqerive, secila shoqeri pjesemarrese ne bashkim duhet te disponoje licensen A/Z – 4"*.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

3. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik "R&T" shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me stafin drejtues te shoqerise, pasi arkitekti i deklaruar me license nga Ministria e Kultures per zbatim ne restaurimin e monumenteve te trashegimise se arkitektures disponon pikat A/2, A/3 dhe A/4 por nuk disponon piken AZ/1 te kerkuar ne kerkesen per kualifikim.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.8 per kualifikim lidhur me mjeteve dhe paisjeve pasi:

Ne lejen e qarkullimit te ekskavatori me rrota gome me targe ACMT80 eshte shenuar se eshte "Per perdorim vetjak".

Ne lejen e qarkullimit te autovincave me targe TR3751K dhe TR 7498S eshte shenuar se jane "Per perdorim vetjak".

Ne lejen e qarkullimit te autoboteve te ujit me targe AA750NR dhe AA823MP eshte shenuar se jane “Per perdorim vetjak”.

Referuar Ligjit 8378, date 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikes se shqiperise”, Pjesa II, Neni 81 “Destinacioni dhe perdorimi i mjeteve” pikat 1,2,3,4,5 dhe 7,8 percaktohet sa me poshte:

Me destinacion te mjetit nenkuptohet perdorimi i tij ne bazë te karakteristikave teknike.

Me perdorim te mjetit nenkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.

Mjetet mund te caktohen per perdorim vetjak ose per perdorim nga te tretët.

Quhet perdorim nga te tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës perkatëse, nga persona te tjerë te ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nenkuptohet perdorimi vetjak i mjetit.

Perdorimi nga te tretët përfshin: a) dhënien me qira pa drejtues mjeti; b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish; c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh; d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve; e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave; f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.

Pra sa më sipër ligjvenesit ka percaktuar se ne rastet kur mjeti jepet me qera ne lejen e qarkullimit destinacioni i mjetit duhet te jete e percaktuar qe mjeti te jepet per perdorim nga te tretët. Në të gjitha rastet e tjera mjeti eshte per perdorim vetjak dhe nuk mund te perdoret nga persona te tjere te ndryshem nga titullari i lejes se qarkullimit kundrejt pageses. Në të tilla raste ligjvenesit ne piken 8 percakton sanksione sipas pikes 8 ku specifikisht citohet: “.....cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një perdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë.”

Pra, bazuar ne sa me sipër, rezulton se keto mjete jane me destinacion perdorim vetjak dhe nuk mund te perdoren nga te trete pasi bie ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi. Mjetet e mesipër nuk mund te konsiderohen te rregullt nga komisioni i vleresimit te ofertave. Ky arsyetim mbështetet edhe ne Vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr. 577 te vitit 2015, si dhe ne Vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr. 296 te vitit 2016.

4. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Vellezerit Hysa” shpk pasi: nuk ka paraqitur oferte.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “Alb Star” shpk, me adrese: Zona Industriale, Patos, Fier, me NIPT J62903512W, se oferta e paraqitur, me vlerë **149.688.322 (njëqind e dyzet e nëntë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e njëzet e dy) lekë** pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Samë Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit ligjor nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **30.08.2018**.

Per proceduren,ne daten 06.09.2018 paraqiti ankese shoqeria "Be Is" shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 07.09.2018 duke mos e pranuar ate. Ankime ne KPP nuk ka patur.

